

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

**L I G J
Nr.9724, datë 3.5.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7874, DATË 17.11.1994 "PËR STATUSIN E
VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË
POPULLIT SHQIPTAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 9 paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:
"Masa vjetore e financimit përcaktohet në Buxhetin e Shtetit. Ministria e Mbrojtjes bën ndarjen e fondit për çdo organizatë veteranësh, bazuar në numrin e anëtarësisë dhe planin vjetor të veprimtarive, të planifikuara nga këto organizata në fillim të çdo viti."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)**